



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	08.12.2020
<b>Referenc-ë:</b>	
<b>Për/ Za/ To:</b>	SHFMU Xhemail Mustafa- Vjollca Jupolli
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike <i>Kastrati</i> Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit <i>Habib</i>
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes-emailit zyrtar nga SHFMU Xhemail Mustafa me përfaqësuese Vjollca Jupolli U.D.Drejtori të cilët kërkojnë shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin “Zahir Pajaziti”,ku do të vendoset një tendë me 4 tavolina dhe katër(4) shkollat kampione do të organizojnë një aktivitet të përbashkët ku të hyrat që do të mblihdhen do të shkojnë për personat me autizëm dhe me sindromën down në shtëpinë e pleqve dhe në spitalin e pediatriisë.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohëshme në pronën publike nr.01-110-157481, i jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike me datën 15,16 dhe 17 Dhjetor 2020 në Sheshin “Zahir Pajaziti”nga ora 14:00 deri në 16:00.

**Kushtet e pëlqimit:**

- nuk lejohet grumbullimi në hapësirë publike më shumë se pesë(5) persona;
- të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ;
- varësishtë nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.

